

01 Nr. 1415  
Datë 28.04.2016

Duke vendosë sipas iniciativës – propozimit të Kryetarit të Komunës, për aprovimin e shpalljes së pavlefshme në mënyrë absolute Vendimin 01.nr.80/2015 të dt. 30.06.2015, të Kuvendit Komunal Rahovec, bazuar në dispozitat e nenit 91 (a), nenit 92 (c) dhe (d), nenit 93 pika 3 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Administrative të Kosovës nr.02-L/28, të dt. 22 korrik 2005, nenit 12.nenit 12 paragrafi.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, nenit 2 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, 01Nr. 569/1 i dt. 16.12.2010, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur me dt.28.04.2016, morri këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës së Rahovecit dhe **Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit Komunal të Rahovecit 01 nr. 80/2015, i datës 30.06.2015**, për shpalljen e interesit të publik dhe Shpronësimin e Pronës së paluajtshme në pronësi private, lidhur me zgjerimin e oborrit të shkollës “Haki Stërmilli”, paralele e ndarë Retijë, në ngastrën kadastrale nr. 321-0, sipas kulturës arë e klasit të dytë (2), në sipërfaqe prej 1817m<sup>2</sup>, z.k. Retijë, në emër të Tërpkoviq Vojisllav (Andrija), në fshatin Zoçisht, Komuna e Rahovecit.
- II. Me Shfuqizimin e **Vendimit 01 nr.80/2015, të dt. 30.06.2015**, shpallen të pa vlefshme të gjitha veprimet faktike dhe juridike të cilat i ka prodhuar ky vendim në të kaluarën dhe atë duke filluar në mënyrë retroaktive që nga data e nxjerrjes së tij.  
Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative.

## A r s y e t i m

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, duke vepruar sipas vendimit të Kuvendit Komunal të Rahovecit, 01 nr. 80/2015, i datës 30.06.2015, ka zhvilluar negociatave me Tërpkoviq Vojisllav (Andrija) që është pronar i ngastrës Kadastrale nr.321-0, sipas kulturës arë e klasit të 2-të në sipërfaqe prej 1817, z.k. Retijë. Pas periudhës së negociatave, pronari i ngastrës kadastrale


Tërpkoviq Vojisllav (Andrija), ka ndryshuar qëndrimin dhe refuzon zhvillimin e procedurës së shpronësimit.

Nga sa u tha më lartë, duke i vlerësuar provat relevante juridike që u shfrytëzuan si bazë për ta Shfuqizuar Vendimin 01 nr. 80/2015, i datës 30.06.2015, Kuvendi Komunal Rahovec në seancën e mbajtur me dt. 28.04.2016, aprovoj propozimin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Rahovecit.

Ky Vendim është i formës së prerë në procedurën administrative.

## KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

 REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 1415      Më 28.04 2016  
Br. prot.                      Dt.  
RAHOVEC - ORAHOVAC

 Kryesuesi i Kuvendit  
Nahit Elshani